



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
Prishtinë / Pristina

Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679, kqz.sekretariat@kqz-ks.org, www.kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 74.4, 74.5, 77.1 (d), 77.2, 77.3, 77.4 dhe 79.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Vendimin e KQZ-së të datës 04.12.2009 për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kryetar të Komunave si dhe nenin 4 të Rregullës Zgjedhore nr. 10/2009 Raundi i dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 07.12.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për emërimin e anëtarëve të KVV-ve për Raundin e II-të të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009 për Kryetar të Komunave

- I. Miratohen rekomandimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve – KKZ për emërimin e anëtarëve dhe Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve – KVV për Raundin e II-të të Zgjedhjet për Kryetar të Komunave që do të mbahet me 13 dhjetor 2009.
- II. Regjistri i anëtarëve, anëtarëve rezervë dhe Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve si në pikën I të këtij vendimi për 21 Komunitat e Republikës së Kosovës në të cilat do të mbahet Raundi i II-të i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave i është bashkangjitur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së që përmes Komisioneve Komunale përkatëse të Zgjedhjeve – KKZ të ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e këtij vendimi.

Prishtinë, 07.12.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve